



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister



Nr.3

REGJISTRIMI I POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILAJRE DHE BANESAVE NË KOSOVË 2023

Letër njoftuese për Komisionet Komunale të Regjistrimit

Prishtinë
Shtator 2023

Date: 26.09.2023

Për: Komisionet Komunale te Regjistrimit

Qëllimi: Letër informuese rreth aktiviteteve ne regjistrimin e popullsisë

Dokumenti shërben vetëm për nevoja te brendshme te KKR-ve duke luajtur rolin informues me proceset dhe aktivitet qe duhet realizuar s’bashku për një regjistrim te suksesshëm.

[Ju lutemi rishikoni me kujdes informacionin e mëposhtëm:](#)

KOMUNIKIMI/KORRESPONDENCA: Bazuar në natyrën dinamike të punës së regjistrimit, është e domosdoshme që s’pkau dy (2) anëtarë nga KKR-të të secilës komunë të jenë si pika kryesore të kontaktit (referuese) për komunikim të vazhdueshëm me ASK-në lidhur me aktivitetet e regjistrimit. Në rekomandojmë si pika referuese te caktoni një (1) anëtar si; nënkryetarin e KKR-së, dhe anëtari tjetër duhet të jetë po ashtu staf i komunës suja dhe anëtarë i KKR-ve. Për të siguruar komunikim e sakte me zyrtare qe ju do ti propozoni dhe duke u bazuar në ndryshimet që janë bere ne disa KKR luteni te konfirmoni listën e anëtarëve nga KKR-ja juaj me disa informacione shtese përfshi personat kontaktues ku ASK-ja përmes zyrtareve kontaktues do të mbajë një linjë të drejtpërdrejtë kontakti me KKR-në e komunës suaj. Ju lutemi gjeni tabelën e mëposhtme qe duhet ta plotësoni/ ri konfirmimin anëtarët e KKR –se ne komunën tuaj.

Tabela 1. Anëtarët e KKR-së (për rikonfirmim):

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita aktuale	Pozita në KKR	Nr. i telefonit	E-maili	Personat kontaktues
01.						
02.	B.....					Person kontaktues
03.						
04.						
05.						
06.	B.....					Person kontaktues
07.						
08.						
09.						
10.						
11.						

KONKURSI: Konkursi për përzgjedhjen e mbikëqyrësve dhe regjistruessve është shpallur dje më datë **26.09.2023**. Secila komunë duhet të ndajë lidhjen (linkun) e konkursit për Mbikëqyrësit dhe Regjistruessit në web faqet e tyre (komunes). Gjithashtu, NJOFTIMI FIZIKË (SHPALLJE) mund të vendosen në mënyrë të dukshme brenda lokaleve të komunës tuaj apo edhe të shpërndahen nëpër vendbanime të ndryshme. Secila komune sot do te merrni numrin e stafit (mbikëqyrësve dhe regjistruessve) për komunën tuaj duke përfshirë numrin e tyre sipas etnicitetit. Është e rëndësishme të theksohet se ekzistojnë dy mënyra aplikimi për poziten e Mbikëqyrësit dhe Regjistruessit: **aplikimet online** dhe **paraqitjet fizike** te dokumenteve brenda komunes suaj¹. Një anëtar i caktuar nga KKR duhet të mbikëqyrë punën e dorëzimit fizikë të dokumenteve dhe zyrtari në fjalë duhet të bëjë futjen e tyre në kohë në sistemin elektronik (aplikacionin) përpara datës së mbylljes së konkursit. **Vetëm aplikimet e dorëzuara (ato që janë në sistem elektronik) deri në afatin e aplikimit do të merren parasysht.** Dokumentacioni i aplikimit fizik duhet të arkivohet dhe ruhet në mënyrë të përpiktë brenda Komunës suaj.

¹ Te bashakngjitur gjeni formularin e aplikimit

FUSHATA PËR APLIKUES (Mb. Regj.): Përveç fushatës nga ASK-ja, secila Komunë inkurajohet të zhvillojë fushata të lokalizuara informuese përmes kanaleve të ndryshme, si mjetet informuese, rrjetet sociale, debatet, takimet ose mjetet e tjera relevante. Qëllimi është që të tërhiqni një numër më të madh të aplikantëve të mundshëm brenda Komunës suaj.

PAGESA: ASK ka kërkuar nga Qeveria që të ndajë një grant për komunat që ndërlidhen me aktivitetet e regjistrimit por ende nuk është vendosur për propozimin.

Mbikëqyrësit dhe Regjistruesit do të marrin pagesë për një periudhë dymujore, që shtrihet nga mesi i tetorit deri në mes të dhjetorit 2023. Mbikëqyrësit do të kenë një pagesë fikse mujore. Regjistruesit, nga ana tjetër, për periudhën 15-ditore (që mbulon trajnimin, listimin dhe aktivitetet paraprake) do të marrin një shumë të caktuar, si dhe pagesën për periudhën nga 1 nëntori deri më 15 dhjetor 2023 (intervistat). Pagesa për regjistruesit do të përcaktohet nga numri i banesave, shtëpive, familjeve, individëve dhe plotësimi i listës së diasporës në zonën e tij/sajë (QR).

KONTRATAT: ASK-ja do t'i përgatisë dy lloje kontratave: një për Mbikëqyrësit dhe një për Regjistruesit. Kontrata nënshkruhet mes ASK dhe palëve (komunat nuk kanë përgjegjësi).

PËRZGJEDHJA (KOMISIONET) PËR MBIKËQYRËS DHE REGJISTRUES: Sipas Ligjit të Regjistrimit të Popullsisë, Mbikëqyrësit do të zgjidhen nga ASK-ja, ndërsa për Regjistruesit, ASK-ja do ta përpilojë listën e ngushtë, që përfshin 50% më shumë kandidatë sesa kërkohet për Komunën dhe atë liste do iu dërgojë juve (KKR-ve) për të finalizuar listën në bazë të numrit të regjistruesve në komune tuaj.

Më datë 06 tetor 2023 ASK do iu dërgojë listën me stafit në listën e ngushtë derisa ju (KKR) keni kohë deri më datë 12 tetor 2023 për të shpallur listën finale që duhet të bëhet publike në webfaqën e komunës suaj, mjetet tjera të informimit apo edhe mund të vendoset përmes listave/njoftimit në objektin tuaj komunal. Ju lutemi, sigurohuni që shpallja publike të bëhet jo më vonë se data **13 tetor 2023**. Pasi të jenë përzgjedhur kandidatët, është përgjegjësi e KKR-së që të komunikojë me regjistruesit menjëherë për detajet e trajnimit, duke përfshirë vendndodhjen, datën dhe orën.

SIGURIMI I HAPËSIRAVE TË TRAJNIMIT DHE RUAJTJES

Hapësirat e trajnimit: Për ta lehtësuar trajnimin efektiv, çdo Komunë duhet të sigurojë hapësira të përshtatshme, që të jenë jo më shumë se 25-30 individë për sallë/klasë. Siç ju është rekomanduar edhe në diskutimet tona të mëparshme, ndarja e hapësirave të trajnimit duhet të përputhet me sugjerimet tona të mëparshme të vendndodhjes (lokacionet). Këto trajnime mund të organizohen në objektet komunale ose shkolla. Këshillohet që të bashkëpunohet me drejtuesit e Drejtorisë Komunale të Arsimit për të siguruar vende të përshtatshme trajnimi në kohë. E rekomanduar që sallat e trajnimit të kenë një projektor apo TV.

Hapësirat e ruajtjes: Shpërndarja e materialeve, duke përfshirë çanta me tabletë dhe pajisjet e tjera, si dhe laptop-ët, është planifikuar të iu dorëzohen komunave me fillim të javës së dytë të tetorit (do iu kontaktojnë stafi nga ASK-ja). Siç kemi diskutuar më parë, është e domosdoshme që çdo Komunë të ndajë një hapësirë të sigurt, brenda objekteve komunale, për ruajtjen e këtyre materialeve (vëmendje t'i kushtohet sigurisë).

Me marrjen e laptop-ëve dhe tabletëve, komuna juaj duhet të sigurojë shpërndarjen e këtyre materialeve tek Mbikëqyrësit dhe Regjistruesit. Ju lutemi, që ta përgatisni një plan shpërndarjeje që më parë.

ORARI I TRAJNIMIT

Trajnime për KKR: trajnime për KKR do të zhvillohet në rajone të ndryshme. Pjesëmarrja aktive e anëtarëve të KKR-së do të sjellë rezultate më të frytshme. Është e këshillueshme, që të paktën gjysma e anëtarëve të KKR-së të marrin pjesë në trajnimin. Ky trajnim është caktuar për datën 06 tetor 2023. KKR-të e rajoneve (7 Rajonet komunale: Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaj dhe Gjilani) , duhet të sigurojnë në kohë sallat/hapësirat për trajnime dhe t'i njoftojnë komunitetet pjesëmarrëse (së paku dy ditë para trajnimeve për lokacionin).

Tabela 2. Lokacionet dhe trajnimet për anëtarët e KKR-ve mbahen në rajone (06 tetor, 2023)

REGJIONI	KOMUNA
Prishtinë	Fushë Kosovë
	Graçanicë
	Lipjan
	Obiliq
	Podujevë
	Prishtinë
	Glllogoc
Mitrovicë	Mitrovicë
	Leposaviq
	Skënderaj
	Vushtrri
	Zubin Potok
	Zvečan
	Mitrovicë e Veriut
Pejë	Deçan
	Istog
	Klinë
	Pejë
Prizren	Dragash
	Prizren
	Suharekë
	Mamushë
Ferizaj	Kaçanik
	Shtime
	Shtërpçë
	Ferizaj
Gjilan	Hani i Elezit
	Gjilan
	Kamenicë
	Novobërdë
	Viti
	Ranillug
	Partesh
Gjakovë	Klllokot
	Gjakovë
	Rahovec
	Malishevë
	Junik

Rreth trajnimeve për mbikëqyrës dhe regjistruës do të njoftoheni në ditët në vijim.

Opsioni i parë i trajnimeve është:

- Trajnimet me Mbikëqyrës në datat 9-13 tetor 2023
- Trajnimet me regjistruës 16-20 tetor 2023
- Listimi i objekteve të QR nga data 23-27 tetor 2023
- Dalja në terren-regjistrimi nga 01 nëntor deri më 15 dhjetor 2023.

Për çdo informacion shtesë ju lutemi kontaktoni :

- | | | |
|------------------|--|------------------|
| 1. Ylli Shala | Ylli.Shala@rks-gov.net | +383 44 22 03 22 |
| 2. Bekim Canolli | Bekim.canolli@rks-gov.net | +383 44 64 30 29 |
| 3. Ilir Mazrekaj | Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net | +383 45 53 70 38 |